



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kosova Net  
Burim QEHAJA  
Drejtor  
Kamenicë

Ankesa Nr. 2016/34 KPM vs Kosova Net  
Ref:1606/597/KPM/am

### VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2016/34 – Komisioni i Pavarur i Media (KPM) kundër Kosova Net  
("Pala Përgjegjëse")

---

### Faktet

1. Pala Përgjegjëse me datë 30 tetor 2013, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. Komisioni i KPM-së me datën 28 prill 2015, ka marr Vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në shumë prej 5.000 (pesëmijë) euro për shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
3. Komisioni i KPM-së, sërish me datën 27 tetor 2015, ka marr Vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në shumë prej 5.000 (pesëmijë) euro për shkelje të vazhdueshme të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
4. KPM, në mënyrë të vazhdueshme ka pranuar ankesa nga operatori kabllor IPKO ndaj Palës Përgjegjëse, lidhur me transmetimin e ngjarjeve sportive pa të drejtë autoriale, me theks të veçantë ndeshjeve sportive në kuadër të Ligës Spanjolle dhe Ligës italiane Seria A.
5. Gjithashtu KPM, ka pranuar ankesa edhe nga operatori kabllor Orange Net i cili pretendon se Pala Përgjegjëse, me datën 18 dhe 25 shkurt 2016, 29 mars 2016 dhe 8 prill 2016, ka transmetuar ngjarje sportive pa të drejtë autorialenë kuadër të Ligës Spanjolle, Ligës Italiane Seria A dhe Ligës së Kampionëve.

6. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të paleve ankuese dhe me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me datën 13 prill 2016, ka bërë monitorimin e programeve të ri-transmetuara nga Pala Përgjegjëse, dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse përmes kanalit Vision Plus, në kuadër të Ligës së Kampionëve, ka transmetuar ngjarjen sportive në mes të Atletico Madrid dhe Barcelonës.
7. KPM me datë 15 prill 2016, përmes një kërkesë ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse, që në afat prej pesë (5) ditësh t'i sjellë marrëveshjet valide me të cilat dëshmon se posedon të drejtat për ri- për ritransmetimin e ngjarjes futbollistike ndërmjet Atletico Madrid vs Barcelona.
8. KPM, bazuar në shkeljen e Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 28 prill 2016, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
9. Edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i deponojë dëshmitë se posedon të drejtat për ri-transmetimin e ngjarjeve futbollistike, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

#### Analiza Ligjore

10. Komisioni i Pavarur për Media bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:

*“I licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës”.*

11. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë ritransmetimin e ngjarjeve sportive pa të drejtë autoriale.
12. Komisioni i KPM-së, duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marr hapa të nevojshme për të ardhur në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, ka bërë ritransmetimin e ngjarjeve sportive pa të drejtë autoriale.
13. Komisioni i KPM-së ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me nenin 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të respektimit të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, prandaj përmes kësaj Komisioni si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse ka marrë shkeljet e vazhdueshme edhe pas Vendimit sanksionues të datës 28 prill 2015 dhe datës 27 tetor 2015 dhe kërkesave tjera të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.

14. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni i KPM-së vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka bërë ritransmetimin e ngjarjeve sportive pa të drejtë autoriale.

### Vendimi


15. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka bërë ritransmetimin e ngjarjeve sportive pa të drejtë autoriale.
16. Komisioni, bazuar në nenin 30 paragrafi 1 pika 4, të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me pezullim të licencës me kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, për shkelje të vazhdueshme të nenit 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
17. Pala Përgjegjëse obligohet që të pezulloj transmetimin në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh nga dita e pranimit të këtij Vendimi. Dështimi i Palës Përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi do të rezultojë me ndërprerje të licencës së transmetimit dhe konfiskim te aparaturës përkatëse konform nenit 30, paragrafi 1 dhe 5 të Ligjit të KPM-së.

### E drejta për Ankesë

18. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
19. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërishit relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

### Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



01.06.2016

datë

Lloji i dërgesës  
Vista postiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar  
Oznaçona vrednosi - postari iznos

nën numër \_\_\_\_\_

pod br. KOSOVA NËS" B.YEIN QEMAJA

për QIRI/SHESHI SIGËNDEKRETA P.N /KAMUKUCE

(Vendi)  
(Mesto)

Posthtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dotëzuar në rregull (paguar me datë) Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta postiljka (postari iznos) predata uredno (placena dana)

15/06/16

Nënshkrimi i marrësit  
Potpis primaoca

B Q.

Wila e postës së vendit

Peçat pošte



Nënshkrimi i nënpunësit  
të postës së vendit  
Potpis radnik pošte

[Signature]